

# REFORMIMI I SISTEMIT TË PARABURGIMIT NË SHQIPËRI NË RAPORT ME STANDARTET E BASHKIMIT EUROPIAN

MA. Femi Sufaj\*

**Abstrakt:** Ky punim ka për qëllim të prezantojë arritjet e reformave të ndërmarra në vitet e fundit në Shqipëri për përmirësimin e standardeve të respektimit të të drejtave themelore të personave që akuzohen për kryerjen e veprave të ndryshme penale dhe mbi të cilët është vendosur nga gjykata masa e sigurisë “arrest me burgim”. Punimi përfshin një vështrim historik mbi sistemin e paraburgimit në Shqipëri gjatë shekullit XX, me theksim të veçantë periudhën e sistemit totalitar (1945-1990). Në vijim evokohet periudha e transformimeve demokratike dhe nevoja e reformimit të sistemit penitenciar prej vitit 1991 deri tani. Kjo është parë në këndvështrimin e standardeve të BE për respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe në veçanti të personave që ndodhen të burgosur. Bazuar në hulumtimet e kryera në disa qendra paraburgimi në vend dhe në intervistat me disa grupe të prokurorëve dhe gjyqtarëve do të evidentohen disa probleme dhe shqetësime lidhur me procedimin penal, rastet e aplikimit të masës së sigurisë “arrest me burg” dhe respektimi i të drejtave të njeriut në sistemin e paraburgimit. Nëpërmjet të dhënave statistikore dhe rezultateve të kërkimeve do të argumentohet mundësia e zbatimit të masave të tjera alternative të sigurisë, ndaj personave që akuzohen për kryerjen e veprave penale, si një mënyrë më e përshtatshme dhe më efektive për parandalimin e kriminalitetit.

**Fjalë çelës:** Reformim, respektimi i të drejtave, të paraburgosur, masat alternative, standardet ndërkombëtare.

## 1. Vështrim historik mbi sistemin e ekzekutimeve të vendimeve penale nga viti 1912 deri 1944

Puna e institucioneve të ekzekutimeve të dënimeve penale gjatë periudhave të ndryshme të historisë së vendit tonë ka pasqyruar në mënyrë të drejtpërdrejtë sistemin politik qeverisës të kohës. Që nga fillimi i shekullit të njëzetë, kur Shqipëria i është shtuar hartës politike të Botës si shtet i pavarur dhe sovran, institucionet e dënimeve penale (burgjet) kanë ndryshuar në mënyrë rrënjësore. Ndryshimet kanë qenë në konceptet mbi të drejtat e njeriut, në qëllimin e këtyre institucioneve, në mënyrat e trajtimit, menaxhimit, organizimit dhe arkitekturën e tyre. Deri në vitin 1944 (çlirimi i vendit nga okupatorët

---

\* Departamenti i Historisë Universiteti i Tiranës, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve. Autori mirëpret sugjerime në [fsufaj@yahoo.com](mailto:fsufaj@yahoo.com).

dhe vendosja e regjimit komunist), institucionet e dënimeve penale karakterizohen nga disa tipare, të cilat janë besnike të alternativave qeverisëse.

Së pari, gjatë kësaj periudhe si rezultat i nivelit të ulët të zhvillimit ekonomik ka ekzistuar një infrastrukturë mjaft e dobët, me arkitekturë të pa përshtatshme që nuk garantonte sigurinë, trajtim njerëzor, kushtet higjieno-sanitare dhe mundësi për risocializimin e të dënuarve. Burgjet më të rëndësishme që u trashëguan nga sundimi turk, ishin burgju i Shkodrës, Gjirokastrës, Korçës, Elbasanit dhe burgje të tjera të cilat ishin në çdo qendër prefektore. Shumica e tyre ishin thuajse të shkatërruara, kështu një pjesë e madhe e të burgosurve janë mbajtur në shtëpi private, të marra me qera nga shteti. Në një raport që Ministria e Drejtësisë i bën Ministrisë së Brendshme me 17.09.1921 mbi burgun e Tiranës midis të tjerave shkruhet: "*... Në tri dhoma që ka burgju me shtërngim të madh , ishin 67 vetë. 70 të burgosur flenin përjashtë në oborr e disa nën strehë. Në këtë mënyrë rrojte i duket njeriut si me qenë dënuar me vdekje me mundim. ...Kjo është despotizëm, një sjellje kundër jetës njerzore*". Raporte të shumta vinë nga vitet e largëta, veçanërisht nga specialistë të huaj të cilët ishin thirrur për të ndihmuar në organizimin e shtetit shqiptar. Nga shqyrtimi i dokumentacionit arkivor, rezulton që, disa shqiptarë, të cilët ishin dënuar për krime në kohën e Luftës së Parë Botërore, të jenë dërguar për të vuajtur dënimin jashtë territoreve të Shqipërisë, në kolonitë e vendeve pushtuese. Një rast i tillë është dokumentuar të jetë dërguar në Guajanën franceze.

Gjatë kohës së Monarkisë Zogiste u rikonstruktua burgju i Gjirokastrës brenda në kalanë e këtij qyteti (1928) i cili ka qenë në përdorim deri në v. 1955." ...Mënyra konstruktive e tij, - shkruante inspektori i oborrit Mbretëror Xh. Ypi me 1932, - nuk pajtohet me ekzistencën e njeriut". Në vitin 1930 u ndërtua Burgju i Tiranës, i cili është akoma në funksionim në 50% të godinës. Gjatë Luftës Dytë u hapën shume burgje të tjera si burgju i Burrelit, burgju i ri i Tiranës, sot Institucioni Paraburgimit në Rr. "J. Misja" dhe disa kampe internimi si Porto Romano, në të cilët ishin vendosur anëtarë të lëvizjes antifashiste. Gjeneral armate G. Pagrili e ka përshkruar në këtë mënyrë situatën e përgjithshme të burgjeve gjatë Luftës në vitin 1942: "Burgjet civile të Shqipërisë ndodhen në lokale provizore, që zakonisht veçse u mungon çdo veti higjienike e morale, nuk janë të përshtatshëm edhe për sa i përket sigurisë. ...Në burgje ruhen të përzier të dënuar me ndëshkime të gjata dhe me ndëshkime të përjetshme, me ndëshkime të lehta dhe në pritje të gjykimit. Dëmi që rrjedh nga një përzierje e tillë është i qartë dhe se burgju dështon dhe si qëllim riedukimi moral i të dënuarve për faje të rrepta".

Së dyti, deri në vendosjen e regjimit të Zogut për drejtimin dhe organizimin e sistemit të burgjeve kanë qenë në fuqi aktet ligjore të trashëguara nga regjimi turk. Ligji penal i 28 prillit 1910 në disa dispozita rregullonte administrimin e burgjeve (nenet 131-149).Gjatë periudhës së Luftës Parë, shtetet pushtuese si Austro-Hungaria, Franca, Italia u përpoqën

të bëjnë zëvendësimin e akteve dhe kodeve , por periudha e pamjaftueshme bëri që të mos bëhej implementimi i tyre. Krijimi i kuadrit ligjor filloi pas vitit 1920, periudhë që ka të bëjë me ngritjen e organeve të larta të pushtetit nga Kongresi i Lushnjës. Me 23.5.1921 Këshilli i Lartë i shtetit ngarkoi qeverinë për hartimin e një projekt ligji për përmirësimin e jetës së të burgosurve si në shtetet e qytetëruara. Ndër aktet e para ligjore është Ligji “Për përdorimin e të burgosurve në punë” i nxjerrë nga Këshilli i Lartë me 31.1.1923. Në krijimin e kuadrit ligjor kanë luajtur një rol të rëndësishëm specialistët e huaj të vendosur pranë qeverisë shqiptare veçanërisht specialistët anglezë. Në gusht të vitit 1933 hyri në fuqi rregullorja e re e burgjeve, e hartuar mbi bazën e një pakete “Përmbledhje e rregullave mbi trajtimin e të burgosurve” dërguar nga Lidhja e Kombeve nëpërmjet Ministrisë së Jashtme me 9.11.1931. Rregullorja është miratuar me vendim të qeverisë dhe është e firmosur nga gjithë kabineti qeveritar pasi për zbatimin e saj kishin detyrime të gjitha ministrinë sipas drejtimeve përkatëse.

Së treti, nëpërmjet akteve ligjore dhe dokumentacionit arkivor që lidhet me institucionet e dënimeve penale evidentohet karakteri publik i këtij shërbimi. Në letrën e prokurorit të Korçës Sali Babeni në vitin 1917 të drejtuar këshillit qeverisës të qytetit theksohet se burgju në vend që të administrohet nga një nëpunës cili i cili duhet të ketë përgjegjësinë që i ngarkon procedura ka mbetur vetëm nën kujdesin e policisë. Në një dokument mbi zgjedhjen e drejtorit të burgut të Vlorës, me 8 qershor 1922, thuhet që konkursi zhvillohet në mbështetje të Qarkores së Ministrisë së Punëve të Brendshme 728/1 datë 3.2.1921 “Për emërimin e nëpunësve të administratës civile të shtetit”. Në rregulloren e burgjeve të v. 1933, përcaktohej struktura e drejtimit të burgut.

Së katërti, vërehet fryma njerëzore e trajtimit të të burgosurve. Nëpërmjet një numri të konsiderueshëm dokumentesh, tërhiqet vëmendja e strukturave përgjegjëse, në rastet kur ka shkelje të të drejtave të burgosurve dhe aq me tepër kur vërehen keqtrajtime.(Për më gjërë shih tekstin Historia e Burgjeve të Shqipërisë, e të njëjtit autor). Trajtim dhe sigurimi i të paraburgosurve, është bërë me standarde të ndryshme në raport me të dënuarit. Ndonëse parimisht një person i pa gjykuar konsiderohet i pa fajshëm, kjo kategori trajtohen me kushte më të rënda. Në një shkresë që prokurori i Vlorës i drejton Ministrisë së Punëve të Brendshme në korrik 1942, midis të tjerave thuhet: “....Neve si autoritet i deleguar që respektojmë ligjet dhe ti bëjmë edhe të tjerët t'i respektojnë nuk mund të largohemi prej parimit, sipas të cilit të pandehurit nuk mund të konsiderohen fajtorë derisa nuk janë të deklaruar si të tillë nga autoritetet gjyqësore, prandaj edhe trajtimi i tyre duhet të jetë i ndryshëm”. Një situatë mjaft e vështirë në lidhje me trajtimin dhe respektimin e procedurave ligjore të të paraburgosurve është krijuar në periudhën e Luftës së Dytë Botërore. Në këtë periudhë një pjesë e të dënuarve dhe paraburgosurve u vendosën në burgjet e Italisë, për arsye të sigurisë. Transferimi i tyre larg atdheut solli që të zvarriteshin proceset gjyqësore të qindra të paraburgosurve.

### **1.1 Shkallëzimi i ndjekjeve dhe dënimeve penale gjatë sistemit totalitar**

Vitet e para të instalimit të pushtetit komunist u shoqëruan me një dhunë dhe sulm të gjithanshëm kundër të gjithë atyre shtresave e klasave që konsideroheshin kundërshtarë të sistemit komunist, veçanërisht intelektualët, punonjës të administratës së vjetër, përfaqësues të klerit. Goditjes nuk i shpëtuan edhe shtresa të thjeshta e të varfra të popullsisë. Qëllimi i goditjes ishte nënshtrimi total i popullsisë dhe sigurimi i fuqisë punëtore të detyruar për të punuar në frontet më të vështira të ndërtimit. Eliminimet dhe burgosjet filluan që në vitin 1944. Burgosjet ishin dënim i zakonshëm gjatë kësaj periudhe. Shumë dënime u dhanë me vdekje dhe kryesisht pa gjyq, në emër të luftës dhe të situatës së jashtëzakonshme. Të parët që u vunë në shënjestër me vendosjen e pushtetit komunist ishin personat e cilësuar kriminelët e luftës dhe bashkëpunëtor me fashizmin.

Në të gjitha vendet e botës kishin filluar proceset gjyqësore të dënimit të kriminelëve të luftës. Por në vendin tonë ky proces mori përmasa shumë më të gjëra dhe u krye jo në frymën e drejtësisë, por të hakmarrjes.” Një ngjarje e shëmtueme në qendër të qytetit, ra si bomba e parë që zgjoi qytetarët, sinjali i parë i asaj që do të vinte më vonë. Një grup “bashkëpunëtorësh” me okupatorin, u ekzekutuan publikisht në sheshin kryesor.....Një turmë qytetarësh të heshtun, vështronte me tmerr këtë masakër, ekzekutime publike , sipas modelit nazist, pa proces, pa gjyq, pa mbrojtje ligjore, pa të drejtë apeli. Ishte shija e parë e shoqënisë së re” - kështu shkruan profesor Sami Repishti, dëshmitar okular, i cili më vonë u bë edhe vetë objekt i goditjes. Me datë 1 mars 1945 një gjykatë speciale në Tiranë me kryetar Koçi Xoxen dha 17 dënime me vdekje 8 dënime më burg të përjetshëm, 10 me 30 vjet burg dhe 23 të tjerë me 2 deri në 20 vjet burg. Këtu përfshiheshin zyrtar të lartë të ish pushtetit të kaluar, ish nacionalistë, ballistë etj të cilësuar si bashkëpunëtor me okupatorin dhe kriminelë lufte. Çdo ditë kishte ekzekutime dhe burgosje masive. Procedurat ligjore mungonin. Objekt i goditjes ishin bërë edhe individ e familje me reputacion dhe besueshmëri për qëndrimin e tyre nacionalist.

Qeverisë dhe Enver Hoxhës i vinin letra e lutje nga të gjitha anët për faljen e jetës së personave të akuzuar, por ndaj tyre tregojnë indiferencë. Një familjar nga Vlora shkruan: ”Si një katundar i thjeshtë i gënjyer me një politikë të gabuar , veprova me sy mbyll, një djalë në moshën madhore që kisha ma vranë, ju lutem më falni tjetrin”. Dënimet me vdekje jepeshin si një akt i thjeshtë administrativ, pa procedura dhe prova të plota. Kjo kishte tërhequr vëmendjen edhe të disa drejtuesve të gjykatës së lartë. Në një letër të Kryetarit të Gjykatës së Lartë Ushtarake të datës 26.11.1947 drejtuar Gjykatës ushtarake Gjirokastër me mbishkrimin “tepër rezervat” thuhet: “ ...Në gjyqet që do të zhvillohen duhet të kufizoni dënimet kapitale, do ta jepni këtë dënim vetëm në rast se është tepër serioze. Bën përshtypje të keqe kjo masë kaq e rreptë, prandaj shikojeni mirë këtë punë, mos u kënaqni kur jepni vetëm dënim kapital. Dënimet kapitale duhet të jepen të rralla dhe me vend”. Me 1 tetor 1946 Ministria e Mbrojtjes Kombëtare me një urdhër që është

REFORMIMI I SISTEMIT TË PARABURGIMIT NË SHQIPËRI NË RAPORT ME STANDARDET E BASHKIMIT EUROPIAN

firmosur nga Enver Hoxha me cilësinë e Komandantit suprem të fuqive të armatosura u drejtohet gjykatave ushtarake ku thuhet: “Të gjithë ushtarakët e arrestuar nëpër divizione të kalojnë menjëherë para gjyqit ushtarak dhe vendimi i dënimit të njoftohet brenda datës 5 tetor 1946”. Brenda kësaj date u dënuan qindra ushtarak të niveleve të ndryshme me dënime të gjata dhe me vdekje. Kështu gjykata ushtarake Gjirokastrë njoftonte Ministrinë e Mbrojtjes së ka dënuar 33 ushtarak, 8 me vdekje, 24 me burgim dhe 1 shpallet i pafajshëm. Njoftime vinë nga të gjitha gjykatat ushtarake.

Në vitet e para të vendosjes së regjimit komunist dënimet kanë marrë një shkallëzim të pa parë në historinë e vendit gjatë sh. XX. Në qoftë se gjatë viteve të Luftës, numëroheshin rreth 2500 të burgosur, pa përfshirë internimet në kampet e përqëndrimit, brenda dhe jashtë vendit, në vitin 1950 numri i të burgosurve arriti në 10.000. Nga një analizë e Prokurorisë së Përgjithshme mbi kriminalitetin në Shqipëri nga viti 1947 deri në vitin 1957, rezultojnë këto të dhëna:

a) Krimet kundër shtetit 1950 deri 1957 janë proceduar 4198 persona , nga të cilët 3578 janë dërguar në gjyq. Për 620 janë pushuar hetimet .Sipas viteve janë proceduar:

1950	1951	1952	1953	1954	1955	1956	1957	Totali
846	1160	711	510	229	113	290	319	4198

b) Krimet ushtarake: 1952-1957 janë proceduar 1752 dhe janë dërguar në gjyq 1533. Pushim çështjesh 619.

Sipas viteve janë proceduar:

1952	1953	1954	1955	1956	1957	Totali
407	303	335	340	22	145	1752

c) Krimet ordinere

Nga v. 1948 deri më 1957 janë ndjekur gjithsej 77.709 çështje hetimore. Janë dërguar në gjyq 60.735. Është vendosur pushimi për 16.874. Në këtë numër nuk përfshihen çështjet e hetuara kryesisht nga gjykata ose që janë dërguar në gjyq nga policia.

Në çështjet e viteve 48-57 janë marrë si të pandehur 103.035 veta dhe janë dërguar në gjyq 80.365

Sipas viteve:

1948	1949	1950	1951	1952	1953	1954	1955	1956	1957

REFORMIMI I SISTEMIT TË PARABURGIMIT NË SHQIPËRI NË RAPORT ME STANDARDET E BASHKIMIT EUROPIAN

14.000	21.000	21.045	14.784	10.088	6.653	4.592	4.241	3.263	3.365
--------	--------	--------	--------	--------	-------	-------	-------	-------	-------

Nga v. 1945-1947 janë dënuar nga gjykatat ordinere dhe ushtarake 23.635. Gjithsej numri i personave të proceduar dhe dënuar nga 1945 deri 1957 për krime ushtarake dhe ordinere është **109.111** persona. Duhet marrë parasysh edhe pafajësitë që mund të ketë dhënë gjykata si dhe mungesën e të dhënave për krime kundër shtetit gjatë v. 48-49 dhe për krimet ushtarake gjatë v. 48-51. Për faje ordinere, ndjekje e tregtisë së ndaluar, spekulim, sabotim ekonomik (Ligji 373 dt. 12.12.1946) gjatë vitit 1949 ishin proceduar 4095 persona. Gjatë v. 1950 për mosdorëzim detyrimesh janë dënuar 1600 veta. Për shkelje të disiplinës në punë gjatë v. 1951 janë dënuar 1552.

Burgjet e regjimit komunist u bënë simboli më i qartë i dhunës, shkeljeve të të drejtave të qytetareve dhe shtypjes. Nën shembullin e Gulagut të Bashkimit Sovjetik u ngritën kampet e punës së detyruar ku u grumbulluan mira të burgosur ordiner dhe politik, të cilët kanë punuar në kushte çnjerëzore. Burgjet nga shërbime publike u kthyen në institucione ushtarake. Në vitin 1955, me vendim të Ministrisë së Punëve të Brendshme, kampet e punës dhe burgjet u emëruan reparte, si Reparti 301( kampi Maliqit dhe më vonë i Bulqizës, 303 (Spaçi ), 321 (Burreli), 313(Burgu i Tiranës etj, emërtime këto që kanë mbetur në kujtesë dhe përdorim edhe në ditët e sotme. Nga viti 1945 deri më 1994 burgjet kanë qenë në vartësi të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Në përbërje të drejtorisë së policisë, ka qenë sektori i kampeve dhe burgjeve, i cili është emërtuar në periudhat e mëvonshme, degë e zbatimit të vendimeve penale.

Si të gjitha institucionet e burgjet u pushtuan nga politizimi i tejskajshëm i ligjeve, praktikave të organizimit dhe drejtimit. Kjo u shoqërua me vendosjen në drejtim të burgjeve të komisarëve politik krahas komandanteve, që të dy me uniformë ushtarake. Gjithashtu u shoqërua me futjen e literaturës politike dhe shtypit zyrtar, me forma edukimi komuniste, informacion politik, me emulacion socialist, gjyqë shoqërore dhe këshilla riedukimi, të cilat e shtonin vuajtjen mbi të dënuarin. Lufta e klasave ishte aq e ashpër sa të burgosurit politik zyrtarisht quheshin armiq të popullit dhe si të tilla ishin nën një presion, diferencim dhe keqtrajtim të vazhdueshëm. Gjatë vitit 1991 u mbyllën kampet famëkeqe Spaç, Qafë Bari , Bulqizës, Burgu i Burrelit dhe për një kohë shumë të shkurtër u mbyllën të gjitha kampet e punës duke u trashëguar vetëm dy burgje i Burrelit dhe burgu i Tiranës në gjendje të mjeruar dhe me histori të dhimbshme. Shteti demokratik me ndihmën e pakursyer të organizmave ndërkombëtare ndërmori reforma të thella në të gjitha drejtimet për përmirësimin e shërbimit të burgjeve. Reformat konsistuan në ndryshimin e akteve ligjore dhe nënligjore duke i përafuar me standardet europiane, në ndryshimin e stafit dhe trajnimit të tij, në përmirësimin e kushteve të trajtimit dhe në rehabilitimin social.

## **2. Reformimi i institucioneve të ekzekutimeve të vendimeve penale pas viteve 90**

Reformimi i Institucioneve të Ekzekutimeve të Vendimeve Penale ka qenë dhe vazhdon të mbetet një aspekt mjaft i rëndësishëm i demokratizimit dhe civilizimit të shoqërisë shqiptare në periudhën post komuniste. Ndër hapat e parë të ndërmarrë për reformimin e sistemit të burgjeve ishte kalimi nën administrimin e Ministrisë së Drejtësisë. Kjo mbështetej në parimin më të rëndësishëm që i konsideron burgjet një shërbim publik dhe që drejtohen nga pushteti civil. Në vitin 1994 sistemi i burgjeve të Shqipërisë kaloi nën administrimin e Ministrisë së Drejtësisë, por qendrat e paraburgimit, vazhduan të mbeten si dikur nën administrimin e Ministrisë së Punëve të Brendshme, me një mungesë vëmendje, me kushte të rënda trajtimi e higjiene, me mungesa në personelin e specializuar, dhe mangësi në aktet ligjore e normative.

Qendrat e paraburgimit kanë qenë të vendosura në ambientet e komisariateve të policisë, kryesisht në katet e nëndheshme dhe kishin kushte shumë të rënda. Kapaciteti i tyre, në vitin 2002 ishte rreth 825, ndërkohë kur ishin të arrestuar rreth 1155 persona. Për trajtimin dhe sigurimin e të arrestuarve ishin rekrutuar rreth 138 punonjës policie me uniformë, të cilët mbulonin kryesisht shërbimin e sigurisë. Për shërbime të tjera nuk bëhej fjalë, si shërbimi social, shëndetësor, ligjor dhe logjistik. Kjo situatë ka vazhduar deri në vitin 2007. Me VKM nr 327 date 15.05.2003 në zbatim të rekomandimeve të institucioneve ndërkombëtare u vendos kalimi i sistemit të paraburgimit në vartësi të M. Drejtësisë. Por ky vendim mbeti i pazbatueshëm, pasi në gjithë vendin u kalua nën administrimin e Ministrisë së Drejtësisë, vetëm paraburgimi Vlorë. Në vitin 2007 me urdhrin nr 5821/1 datë 24.01.2007 të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe urdhrin nr 432 datë 23.01.2007 të Ministrisë së Drejtësisë, ka filluar zbatimi i VKM për kalimin e paraburgimeve në vartësi të M. Drejtësisë si pjesë e sistemit të ekzekutimeve të dënimeve penale. Ky vendim është finalizuar në vitin 2007 dhe 2008.

Gjatë vitit 2008 janë ngritur katër institucione të reja në F. Krujë, Vlorë, Durrës dhe Korçë. Në këto institucione të paraburgosurit trajtohen me të njëjtat standarde si të dënuarit dhe kanë të njëjtat të drejta. Kjo shënon një përmirësim në promovimin e të drejtave të personave të arrestuar, të cilët në raport me të dënuarit kanë pasur të drejta më të kufizuara (kujtojmë këtu të drejtën e informimit, të komunikimit dhe vizitave nga familjarët, të përfitimit nga shërbimet sociale dhe shëndetësore). Një hap i rëndësishëm në reformimin e paraburgimeve përbën amendimi i Ligjit nr 8328 datë 16.04.1998 për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve dhe paraburgosurve dhe miratimi i Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve, në të cilat janë paraparë ndryshimet e reja dhe janë përfshirë dispozita të veçanta për sigurimin dhe trajtimin e personave mbi të cilët është vendosur nga gjykatat masa e sigurisë “arrest me burg”. Në këto akte është paraparë më mirë e drejta e informimit të të arrestuarve, të takimeve me familjarët dhe të afërmit dhe zbatimi i programeve për ri-integrimin e tyre. Probleme me të shumta lindin nga zbatimi në

REFORMIMI I SISTEMIT TË PARABURGIMIT NË SHQIPËRI NË RAPORT ME STANDARDET E BASHKIMIT EUROPIAN

praktikë i akteve ligjore dhe nënligjore, veçanërisht gjatë procedimit penal, duke filluar me njoftimin e akuzës ndaj personit që dyshohet për një shkelje, garantimin e mbrojtjes, njoftimin e familjes, qartësimin e të drejtave dhe lehtësive që parashikon ligji për mbrojtjen e individit dhe për zhvillimin e një procesi sa më korrekt e të ndershëm. Nga një monitorim i sistemit të paraburgimit në vitin 2007 nga organizata “Përthyerja”, ku unë kam qenë pjesë e stafit të zbatimit të projektit, kanë rezultuar disa probleme lidhur me procedimin penal:

Së pari në lidhje me të drejtën e mbrojtjes. Në shumicën e akteve ndërkombëtare që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut në përgjithësi parashikohet e drejta e mbrojtjes ligjore. Edhe në K. Procedurës Penale në nenin 6 parashikohet se “I pandehuri ka të drejtë të mbrohet vetë ose me ndihmën e mbrojtësit. Kur nuk ka mjetet e mjaftueshme i sigurohet mbrojtja falas me avokat. Mbrojtësi ndihmon të pandehurin që ti garantohen të drejtat procedurale dhe t’i ruhen interesat e tij ligjore”. Nga personat e intervistuar pranohet se kanë pasur mundësinë e zgjedhjes së një mbrojtësi ligjor në momentin e arrestimit dhe këtë e kanë bërë vetë, e kanë siguruar nga familja , ose është i caktuar kryesisht nga shteti. Nga të gjithë të intervistuarit, 60% pohojnë se mbrojtësin ligjor e kanë siguruar nga familja, 30% e kanë siguruar vetë dhe 10% nga shteti. Në diskutimin me grupet e gjyqtarëve për cilësinë e mbrojtjes ligjore, u ngrit si problem që në caktimin e masës së sigurisë “arrest në burg”, ndodh shpesh që të caktojmë avokatë të rastësishëm, të cilët gjinden në ambientet e gjykatës, ose afër saj dhe ka shumë raste kur këta nuk i kanë aftësitë e duhura. Kjo kërkon një bashkëpunim më të mirë ndërmjet dhomës së avokatisë dhe gjykatës, për të mos ja lënë rastësisë caktimit të një avokati nga shteti, kur kjo është e nevojshme.

Cilësia jo e mirë e mbrojtjes ligjore në momentin e caktimit të masës së sigurisë, është një faktor që ka ndikuar në shumë raste në marrjen e një vendimi unanim me kërkesën e prokurorisë. Kështu nga shqyrtimi i masave të sigurisë të dhënë nga gjykata e Tiranës në vitin 2004, rezulton se nga 713 kërkesa të prokurorisë për masën e sigurisë arrest me burg, të jenë miratuar 704, pra gati 100%. Në masat e sigurisë të dhëna gjatë vitit 2008, po nga kjo gjykatë, janë dhënë 855 masa sigurie arrest me burg nga 883 të kërkuara nga prokuroria.

	Arrest në burg	Arrest në burg me afat	Arrest në shtëpi	Detyrim paraqitje
Kërkuar nga Prokuroria	883	48	114	219
Dhënë nga gjykata	855	58	114	219



Në parathënien e Rekomandimit (2006)13 të Komitetit Ministror të Bashkimit Europian, Rregullat e përdorimit të arrestit me burg, kushtet në të cilat duhet të mbahen personat dhe mjetet për mbrojtjen ndaj abuzimit, thuhet se qëllimi i këtyre rregullave është:

- a) Vendosja e kufizimeve strikte në përdorimin e arrestit me burg;
- b) Inkurajimi dhe përdorimi i masave alternative, kurdo që është e mundur;
- c) Marrja e vendimit për vendosjen, ose heqjen e masës arrest në burg, vetëm nga një autoritet gjyqësor;
- d) Të sigurohet që mbajtja në arrest në burg është në kushte dhe regjim të përshtatshëm me statusin, i cili bazohet në prezumimin e pafajësisë;
- e) Të sigurojë përdorimin e një mbrojtje efektive kundër prishjes së mundshme të rregullave.

Probleme vërehen gjatë kohës së marrjes në pyetje nga prokurorët ose oficerët e policisë gjyqësore. Të paraburgosurit janë shprehur për mospjesëmarrje të avokatit gjatë seancave të pyetjes, veçanërisht në momentin e arrestimit. Madje janë shprehur se në shumë raste prania e mbrojtësit ligjor ka qenë fiktive, vetëm sa për të nënshkruar dokumentet, dhe më pas nuk kanë pasur kontakte me të. Nga të intervistuarit, 58% kanë deklaruar se janë pyetur pa praninë e mbrojtësit ligjor. Cilësia e punës së avokatëve ka ndikuar edhe në zgjatjen e procedimit penal, gjë që është bërë objekt diskutimi dhe debati në rrethet gjyqësore dhe të prokurorisë dhe për më keq me gjithë presionet e deritanishme, nuk është gjetur një zgjidhje e drejtë. Në faqen e internetit të Gjykatës së shkallës së parë Tiranë, mbi kohëzgjatjen në ditë të gjykimit, konstatohet se 1.41% e çështjeve janë zgjat më shumë se 720 ditë. Mbi 360 ditë janë rreth 7.38 %. Këto të dhëna i përkasin periudhës janar-qershor 2009.

Nga studimi i 500 rasteve pa përzgjedhje , që u përkasin viteve 2001-2009, në Shqipëri rezulton se periudha e paraburgimit (periudha nga marrja e masës arrest në burg deri në vendimin e formës së prerë), ka zgjatur 11 muaj dhe 20 ditë. E krahasuar me disa vende të BE, si Austria në vitin 2008, periudha e paraburgimit ka qenë 68 ditë. Në Belgjikë, nga viti 1996 deri më 2001, periudha e paraburgimit ka zgjatur 84 ditë. Në Greqi, gjatë vitit 2003, periudha e paraburgimit ka zgjatur 1 vit. Në Gjermani gjatë vitit 2006, për 5984 të paraburgosur, kjo periudhë ka qenë më shumë se 6 muaj. Në Francë, gjatë vitit 2005, periudha e paraburgimit, ka zgjatur 8.7 muaji. Në Estoni, gjatë vitit 2002, periudha e paraburgimit, ka zgjatur 10 muaj.

Kodi i Procedurës Penale të R. Shqipërisë parashikon që masa e sigurimit personal vendosen :

REFORMIMI I SISTEMIT TË PARABURGIMIT NË SHQIPËRI NË RAPORT ME STANDARDET E BASHKIMIT EUROPIAN

- a) Kur ekzistojnë shkaqe të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës;
- b) Kur i pandehuri është larguar ose ekziston rreziku që ai të largohet.
- c) Kur për shkak të rrethanave të faktit dhe personalitetit të të pandehurit ka rrezik që ai të kryejë krime të rënda ose të të njëjtit lloj me atë për të cilin procedohet.

Në vendimin 486 datë 12.12.2000 Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka arsyetuar : “ Në kuptim të nenit 228/1 të Kodit të Procedurës Penale për aplikimin e një mase sigurimi kërkohet vërtet një dyshim i arsyeshëm, për kryerjen e një vepre penale, por, nga ana tjetër, ky dyshim i arsyeshëm duhet të mbështetet në prova dhe nuk duhet të jetë i supozuar.”

Në lidhje me arrestin në burg Kodi i Procedurës Penale parashikon kritere të veçanta:

1. Arresti në burg mund të vendoset vetëm kur çdo masë tjetër është e papërshtatshme për shkak të rrezikshmërisë së veçantë të veprës dhe të pandehurit
2. Nuk mund të vendoset arresti në burg ndaj një gruaje që është shtatzënë ose me fëmijë në gji, ndaj një personi që ndodhet në gjendje shëndetësore veçanërisht të rëndë ose që ka kaluar moshën shtatëdhjetë vjeç ose një personi toksikoman apo të alkoolizuar, për të cilin zbatohet një program terapeutik në një institucion të posaçëm.
3. Në rastet e parashikuara në pikën 2 arresti në burg mund të vendoset vetëm kur ka shkaqe të një rëndësie të veçantë për krime që dënohen jo më pak në maksimum se dhjetë vjet burgim.
4. Të miturit nuk mund të arrestohen kur akuzohen për kundravajtje penale.

Në Rekomandimin nr (2000)13 të Komitetit Ministror për përdorimin e masës së arrestimit në burg dhe kushteve në të cilat do të mbahen të arrestuarit, të adoptuara më 27 shtator 2006 parashikohet që aplikimi i arrestimit duhet bërë në rast se:

- a) Ekziston një dyshim i arsyeshëm që ai ose ajo ka kryer një krim;
- b) Ka arsye substanciale për të besuar që në se personi lihet i lirë, do të arratiset, do të kryej një krim më të rëndë, do të ndërhy në procedimin penal, do të kërcënojë rendin publik;
- c) Nuk ka mundësi për të përdorur alternative të tjera;
- d) Ky hap është marrë si pjesë e procesit të drejtësisë kriminale.

Gjatë procedimit penal ndeshemi në raste të shkeljes së të drejtave të qytetarëve , që kanë të bëjnë me njohjen e të arrestuarit me akuzën, njohjen me të drejtën e mbrojtjes, të

drejtën e njoftimit të familjes ose të afërmeve të tij, të drejtën për të mos u shprehur. Rreth 43% të të arrestuarve janë shprehur se u shkelen të drejtat e tyre, veçanërisht gjatë momentit të arrestimit. Në rekomandimin (2000)13 të Komitetit Ministror, në pikën 32 thuhet se një person mbi të cilin është vendosur një masë sigurisë arrest me burgim, ka të drejtë të informojë anëtarët e familjes së tij ose të afërmit për ditën dhe vendin e burgosjes, deri sa kjo nuk do të rrezikonte administrimin e drejtësisë ose sigurinë kombëtare. Në ambientet e paraburgimit janë vendosur telefona për të komunikuar të arrestuarit. Gjatë kohës së arrestit të arrestuarit mund të komunikojnë deri në tetë herë në muaj me familjen dhe të afërmit. Por ata nuk kanë mundësi që të ruajnë konfidencialitetin gjatë komunikimit, pasi bisedat janë të vëzhgueshme nga punonjësi i sigurisë dhe kartofonat nuk janë të izoluar nga zhurma dhe për më tepër nuk janë vendosur në vende të përshtatshme. Pra në disa institucionet të vëzhguara shkelet e drejta e privatësisë, gjatë komunikimit në telefon. Probleme vërehen edhe në të drejtën e korrespondencës. Të arrestuarit që janë intervistuar shprehen se nuk e përdorin shumë këtë shërbim. Por në institucione nuk ka kudo kuti postare, kështu që letrat në shumë raste të arrestuarit i marrin dhe i japin për në postë nëpërmjet punonjësve të shërbimit social, ose punonjësve të tjerë.

Gjatë vitit 2005 në shumë institucione të arrestuarit janë përfshirë në një grevë urie masive, për disa probleme të procedimit penal. Është konstatuar se shumë të arrestuar janë proceduar nga gjykata e krimeve të rënda duke i shtyrë afatet e procedimit penal në maksimum dhe në fund kanë dalë me dënime të lehta, ose të pafajshëm si rasti i disa shtetasve me detyrë në Ministrinë e Transporteve, të cilët u arrestuan me bujë të madhe, para kamerave dhe pas 11 muajve për disa prej tyre u shpall pafajësia. Pra duhet bërë më kujdes jo vetëm në përcaktimin e masës së sigurisë arrest me burg, por veçanërisht në përcaktimin dhe klasifikimin e akuzës. Një pikë mjaft e diskutueshme është roli i medias, e cila nxiton të pasqyrojë çdo informacion në lidhje me situatën kriminale. Por mendoj se duhet të jetë më e kufizuar, pasi siç e theksuam më lartë, shkelet parimi i prezumimit të pafajësisë dhe çënohet dinjiteti i qytetarit.

Mbipopullimi i burgjeve ka marrë vëmendjen e nevojshme të qeverisë dhe po investohet për zgjidhjen graduale. Aktualisht kemi një mbipopullim prej 110%, nga 129% që ishte në vitin 2008. Në Qershor 2009 në Shqipëri ka pasur 4777 të burgosur, ndërsa numri i vendeve (kapaciteti) është 4340 vende. Mesatarja e popullimit të burgjeve, e shprehur në përqindje për çdo 100 vende në Europë, është 97.8%.dhe maksimumi është 152.7% (vendet me densitet më të lartë janë Greqia, Spanja, Hungaria ).

Sipas statistikave të qershorit 2009 Shqipëria ka 4777 të burgosur, nga këta 1766 të paraburgosur ose 36.9%. Nga këto, gra 122 ose 2.5%, të rinj ,67 ose 1.4% dhe të huaj 45 ose 0.9%. Në këto ditë u hap një qendër e re për sigurimin dhe trajtimin e të miturve në

konflikt me ligjin, e ndërtuar sipas standardeve europiane, duke shënuar një hap shumë të rëndësishëm në reformimin e drejtësisë për të mitur në vend. Deri tani Shqipëria ka pasur shumë probleme në trajtimin e të miturve në konflikt me ligjin, të cilat janë bërë të njohura nga organizatat e ndryshme jo qeveritare që kanë monitoruar sistemin. Krahas ndryshimeve infrastrukturore, është punuar shumë edhe me reformën ligjore. Do të përmendim këtu ndryshimin e Ligjit 8321, datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale” në nëntor 2008, në të cilin është parashikuar krijimi i shërbimit të provës. Momentalisht, ky shërbim është duke u organizuar në shkallë vendi, ndërsa aplikimi i tij për moshat e reja nën 18 vjeç, ka kohë që ka filluar. Por që të ketë sukses të plotë implementimi i shërbimit të provës, duhet që të bëhet kujdes në aplikimin e masave alternative të sigurisë. Aplikimi i masës së sigurisë “arrest me burg”, për vepra penale që dënohen më pak se dy vjet burgim, e bllokton mundësinë e aplikimit të shërbimit të provës.

Momentalisht mendojmë se është problem akomodimi i grave të arrestuara. Nuk kanë hapësirat e nevojshme për banim kushte normale higjienë dhe ri-integrim. Mendojmë se është e nevojshme të mendohet një ambient i veçantë për gratë, i cili të përmbushë të gjitha kërkesat për sigurimin dhe trajtimin e grave. Në ngritjen e institucioneve të reja mendojmë të mbahet parasysh shpërndarja gjeografike e kriminalitetit, vendosja e gjykatave, lehtësitë komunikuese dhe faktorë të tjerë. Shumica e institucioneve penale janë ngritur në pjesën qendrore të vendit. Në të ardhmen ka projekte që të ndërtohen institucione të reja në zonën e Shkodrës dhe në Gjirokastrë.

Sigurimi dhe trajtimi i personave që janë të paraburgosur është në detyrimin e stafit të burgjeve. Me kalimin e sistemit të paraburgimit në administrimin e Ministrisë së Drejtësisë, ka ndodhur një ndryshim i madh në mënyrën e trajtimit, përfshi këtu të ushqyerit, higjienën, kushtet e strehimit, zbatimin e programeve ri-integruese, argëtuese, fizike, arsimore, të drejtën e informimit, të lidhjes me shoqërinë civile dhe familjen etj. Me gjithë punën e mirë duhet të themi se ka shumë vend për përmirësime. Në përgjithësi nuk ka një plan konkret individual ose në grupe për zhvillimin e personalitetit të personave për të cilët është ngarkuar të kujdesen. Mundësitë e punësimit mungojnë, thuajse në çdo institucion. Janë bërë projekte nga viti 1992, por nuk kanë qenë të zbatueshme. Ka një fillim pozitiv në disa burgje të vendit, ku janë hapur klasa për nivelin e arsimit të detyrueshëm, si seksione të shkollave të zonës ku janë institucionet penale. Por, konstatohet një frekuentim i dobët dhe një mungesë interesi për ndjekjen e tyre nga të dënuarit dhe të paraburgosurit. Mendojmë se shfrytëzimi i disa mekanizmave ligjor si përfitime për të burgosurit, mund të ndikoi në përmirësimin e situatës dhe rritjen e interesit. Mund të bëhen edhe përmirësime ligjore, ku të parashikohet një përfitim për të dënuarit ose të paraburgosurit që mbyllin me sukses një cikël arsimor, ose kalojnë një klasë. Deri tani të paraburgosurit nuk janë përfshirë në arsimin e detyrueshëm, dhe nuk ka

një plan konkret për këtë edhe pse ka grupe të paraburgosurish që kanë arritur afatet maksimale të procedimit penal.

Në rekomandimin 2000 (13) pika 40 thuhet se mbajtja në arrest në burg nuk duhet të ndërpresë edukimin e fëmijëve ose të rinjve dhe për më tepër nuk duhet të bëhet pengesë për edukimin e avancuar të tyre. Me mbështetjen e organizatave jo qeveritare si UNICEF është bërë e mundur që të hapen kurse profesionale, si mësim kompjuteri tek të miturit në disa qendra paraburgimi, por mund të themi se këto aktivitete janë akoma të izoluara. Në çdo institucion ka një shërbim social që përbëhet nga punonjës social, psikolog dhe specialistë të edukimit, me eksperiencë pedagogjike. Ky shërbim jep mbështetje psikologjike, këshillim, organizon aktivitete me karakter edukimi dhe argëtimi, mbështetje sociale dhe ndjek sjelljen e të dënuarve dhe të paraburgosurve. Por, psikologu duhet të jetë i pozicionuar në shërbimin shëndetësor, si në shumicën e vendeve të Europës dhe kjo jep mundësi për të ndjekur më mirë shëndetin mendor të të dënuarve dhe për të rritur eficiencën e këtij shërbimi. Në disa raste të vetëvrasjeve dhe të situatave të tjera të ndodhura, ka rezultuar se shërbimi shëndetësor dhe psikologu, nuk kanë pasur një plan monitorimi dhe për më tepër nuk kanë qenë në gjendje të kapin simptomat që paralajmërojnë një sjellje vetëvrasëse, apo çrregullime të shëndetit mendor.

Një vëmendje më e madhe duhet treguar për personat në konflikt me ligjin të cilët janë përdorues të drogave. Është e nevojshme që të krijohen seksione të veçanta pranë çdo institucioni dhe të hartohen programe specifike rehabilitimi. Organet e procedimit penal, nuk e kanë mbajtur parasysh këtë aspekt, edhe pse parashikohet në Kodin e Procedurës Penale, që personat toksikoman apo të alkoolizuar, për të cilin zbatohet një program terapeutik në një institucion të posaçëm nuk mund të vendosen në masë sigurie arrest në burg, vetëm kur parashikohet një dënim në maksimum 10 vjet.

Kohët e fundit në Shqipëri është ngritur Mekanizmi Kombëtar për parandalimin e torturës. Ky veprim është sanksionuar në Ligjin nr 8328, datë 16.04.1998, i ndryshuar. Nga monitorimet e disa organizmave ndërkombëtar, gjatë viteve të fundit, kanë rezultuar raste të keqtrajtimit në dhomat e ndalimit të komisariateve të policisë dhe në paraburgime. Ndryshimet pozitive të ndodhura në vitet e fundit, kanë sjellë një frymë të re në trajtimin e të dënuarve dhe të paraburgosurve, në përputhje me standardet e pranuar ndërkombëtare.

### **3. Konkluzione**

Si konkluzion do të mjaftonte fjala e Nelson Mandelës, “Thuhet se askush nuk e njeh me të vërtetë një komb, pa u futur njëherë brenda burgjeve të tij. Një komb nuk duhet të gjykohet nga mënyra si i trajton qytetarët e tij shembullorë, por ata më të këqijtë”.

## **Bibliografia**

### *Burime arkivore:*

AQSH Fondi Gjykata e apelit Shkodër, Viti 1917 Dosja 1

AQSH Fondi 347, Viti 1914 Dosje 23

AQSH Fondi 152 Viti 1926 Dosja 375

AQSH Fondi 317 Viti 1917 Dosje 11

AQSH Fondi 155 Viti 1923 Dosje 136

AQSH Fondi 152 Viti 1923 Dosje 923

AQSH Fletore Zyrtare nr 57 datë 27 shtator 1933

AQSH Fondi 152 Viti 1921 Dosja 371

AQSH Fondi 150 Viti 1932 Dosje 269

AQSH Fondi 155 Viti 1942 Dosja 1242

AQSh ,F.516,D.11,V.1945

AQSH F.516 G, L.Ushtarake, V.1945,D.5

AQSH F.Këshilli Ministrave V.1945 D 360

AQSH.F 516 (Gj.L.Ushtarake) V.1947 D.21

Arkivi i Ministrisë së Punëve të Brendshme F.DKB.D 1-147viti 1946-1974

AQSh Fondi Prokuroria e Përgjithshme, Gjykata e Lartë, Ministria e Brendshme,  
Ministria e Drejtësisë,Kuvendi Popullor,Këshilli Ministrave. 1945-1984

### *Akte ligjore:*

Statuti Themeltar i Mbretërisë Shqiptare, viti 1928, Bot.I, Tiranë.

Kodi Penal i Shtetit Shqiptar, viti 1928, Bot. Këshilli i Shtetit, Tiranë 1940

Rregullore e Burgjeve, Fletore Zyrtare, nr.57, dt.22.09.1933

Kodi penal i R.P. Shqipërisë v. 1952

Kodi penal i R. Shqipërisë 1995

Kodi i Procedurës Penale të R.Shqipërisë 1995

Ligji 8328 datë 16.04.1998

Rregullore e Përgjithshme e Burgjeve

*Materiale të tjera:*

Norval Morris and David J. Rothmans. The Oxford History of the Prison. The practice of punishment in Western Society. Bot I. New York Oxford. Oxford University Press,1995.Bot II 1998

Elezi, Ismet, Zhvillimi Historik i Legjislacionit Penal në Shqipëri, Tiranë, Bot I. 1997

Arshi Pipa, Libri i Burgut, Rilindja, 1994

Sami Repishti, Nën hijen e Rozafës, Onufri, 2004, fq. 102

Sufaj, Femi. Histori e Burgjeve të Shqipërisë, Albin: Tiranë, 2000

-Të drejtat e njeriut në sistemin e paraburgimit në Shqipëri, 2007

-Drejtimi i burgut nga këndvështrimi i të drejtave të njeriut (libër udhëzimesh)

*Faqe elektronike:*

[www.ijjo.org](http://www.ijjo.org)

[www.prisonstudy.org](http://www.prisonstudy.org)

[www.epea.org](http://www.epea.org)